

Njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit nga ana e FENIKS Germania Holding GmbH, Gjermani mbi HAEMATO Farm GmbH, Gjermani

(lënda nr. 08-153 / 2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 28.10.2025 në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin FENIKS Germania Holding GmbH me seli të regjistruar në Pfingstweidstrasse 10–12, Gjermani, planifikon të fitojë kontroll të vetëm mbi HAEMATO Farm GmbH, me seli të regjistruar në Lilienthalstr. 3a, D-12529 Schönefeld, Gjermani.

-FENIKS Germania Holding GmbH është pjesë e Grupit të kompanive FENIKS (“Grupi FENIKS”), në pronësi dhe i menaxhuar nga ndërmarrja mëmë e grupit – FENIKS Farma SE (PHOENIX Pharma SE), me seli në Pfingstweidstrasse 10–12, 68199 Mannheim, Gjermani. Grupi FENIKS është aktiv në tregtinë me produkte farmaceutike dhe pajisje mjekësore në 29 shtete në mbarë Evropën dhe punëson afërsisht 49,000 njerëz.

Grupi FENIKS ka dy shoqëri të varura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut:

-FENIKS Farma SHPKNJP¹ me seli të regjistruar në Jadranska Magistrala 31, Shkup, Butel, Maqedonia e Veriut dhe veprimtari parësore - tregti me shumicë me produkte farmaceutike.

-Evropa Lek Farma SHPKNJP me seli të regjistruar në Jadranska Magistrala 31, Shkup, Butel, Maqedonia e Veriut dhe veprimtari parësore - tregti jo e specializuar me shumicë.

-HAEMATO Farm GmbH është një tregtar i specializuar me shumicë për produkte speciale (ang. *short-line wholesaler*) që distribuon barna të shtrenjta për HIV/AIDS, neurologji, onkologji, reumatologji dhe oftalmologji, dhe furnizon me importe (paralele) nga EEO) dhe me preparate të miratuara në Gjermani për pikat e shitjes me shumicë dhe barnatoret në Gjermani dhe Austri.

HAEMATO Farm GmbH nuk është as aktive, as nuk gjeneron qarkullim në Maqedoninë e Veriut.

Tregjet relevante

Transaksioni i propozuar potencialisht i referohet tregut të tregtisë me shumicë të produkteve farmaceutike në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka asnjë efekt në tregun e Maqedonisë së Veriut, pasi Shoqëria e synuar as nuk është e pranishme dhe as nuk gjeneron qarkullim në Maqedoninë e Veriut.

Në bazë të hetimit preliminar, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

¹ FENIKS Farma SHPKNJP është në proces të shitjes tek VEGA shpk, transaksion i cili planifikohet të kompletohet deri në fund të tetorit 2025. Përqendrimi përkatës u miratua nga Komisioni me numër lënde: PA. nr. 08-55, të datës 3 prill 2025.

Komisioni u bën thirrje palëve të treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

31.10.2025

Shkup